REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E OBILIQIT-OPŠTINA OBILIĆ
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME
UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE
Dalës-Izlazna
Nr.-Br. I-114 Data-Datum 28.06.2019
OBILIQ-OBILIĆ

Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

Në mbështetje të nenit 12.2, pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare nr.28 të dt.04.06.2008), nenit 44.1 dhe 47.3, të Statutit të Komunës si dhe nenit 39 të Rregullores së punës së Kuvendit, Kuvendi komunal në mbledhjen e mbajtur me dt.28.6.2019, mori këtë:

# VENDIM

1. **Shfuqizohet vendimi me nr.I-25, i dt.28.02.2018, për formimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim .**

2. **Arsyetim : Me hyrjen në fuqi të Ligji nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës ndryshon edhe përbërja e Komisoneve**

3. **Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyren e protokolit të MAPL-së, si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës.**

Kryesuesi i Kuvendit Komunal
Burim Gërguri

T'i dërgohet
-Kryetarit
-Kryesuesit
-Nënkryetarit
-MAPL
-DPUKP
-Anëtarëve të KK
-Arkivit

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E OBILIQIT-OPŠTINA OBILIĆ
DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME
UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE
Obiliq Obilić
Nr. -1-25
Br.
Data 28.02.2018
Datum
OBILIQ-OBILIĆ

Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

Në mbështetje të nenit 12.2, pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare nr.28 të dt.04.06.2008), nenit 44.1 dhe 47.3 të Statutit të Komunës dhe nenit 11 dhe 3.9 të Rregullores së punës të Kuvendit, bazuar në Ligjin nr.04/L-144, për dhënjen në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, neni 6 dhe 7, Rregullorja nr.23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënjes në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës, neni 11, 12, Kuvendi komunal në mbledhjen e mbajtur me dt. 28.02.2018, mori këtë:

# V E N D I M

1.Formohet Komisioni për shqyrtimin e ankesave për dhënjen e pronës komunale në shfrytëzim me këtë pëbërje:

1. Zarife Behluli. Kryetare
2. Edin Hashani, anëtar
3. Ibush Mjekiqi, anëtar

2. Obligohet Komisioni që për punën e vet të përpiloj procesverbal me shkrim dhe për këtë ta njoftoj Kuvendin komunal.

3.Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyren e protokolit të MAPL-së, dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në web faqen e Komunës.

T'i dërgohet
-Kryetarit
--Kryesuesit
-Drejtorit të ad.së përgj.
-Anëtarëve të Komisionit
-Këshilltarëve
-MAPL
-Arkivit

Kryesues i Kuvendit komunal
Burim Gërguri